



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 973/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren, paraqitur kundër komisionerit të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor të raundit të dytë gjatë zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Prizren.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 01.12.2013, nga ana e subjekti politik PDK, dega në Prizren, në të cilën pretendohet se rreth orës 15:00 në qendrën zgjedhore nr.2041/a 002 në fshatin Billushëk në Prizren, Milaim Sejramaj nga fshati Billushë, komuna e Prizrenit, komisioner i subjektit politik LDK ka nënshkruar vet në emër të 6 (gjashtë votuesve) në Librin e Votimit dhe më pastaj i ka tërhequr 6 (gjashtë) fletëvotime të vulosura dhe më pastaj i ka plotësuar ato, për kandidatin për kryetar komune nga LDK dhe i ka futur në kutinë e votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund të apelojnë vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore të palës ankuese, se në qendrën e votimit 2041/a në fshatin Billushë, Komuna e Prizrenit, komisioneri i LDK-së ka nënshkruar dhe ka plotësuar fletvotime të vulosura në favor të kandidatit të LDK-së për kryetar të Prizrenit, PZAP-i konstaton se janë të pabazuara dhe të pa argumentuara sepse nuk janë ofruar prova për parregullsinë e pretenduar për të vërtetuar shkeljen e supozuar. PZAP-i, vlerëson se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitesa**

Anr. 973/2013 më datën 04.12.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 ( njëzetekatër )orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.